



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA**

MIRATOI:

TITULLARI ORGANIT QENDROR BLERËS

ENDRI MULLAI

**DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR
PROCEDURËN E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR
MALLRA¹**

OBJEKTI: “BLERJE ARTIKUJ USHQIMORË E NDARË NË 7 (SHTATË) LOTE.

NJOFTIME

¹ Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash, Autoriteti /Enti kontraktor do t'i referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi.

NJOFTIMI PARAPRAK I INFORMACIONIT/ NJOFTIMI PERIDIOK I INFORMACIONIT

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor nëse aplikohet)

1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor;

Emri _____

Adresa _____

1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

Institucion qendror

Njësi e autoriteteve vendore

Institucioni i pavarur

Të tjera

1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Autoritet/ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta

I deleguar

Organ Qendror blerës

Të tjera

1.4 Emri dhe adresa e personit të kontaktit:

Personi (at) përgjegjës për prokurimin: _____

Tel/faks _____

E-mail _____

1.5 Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

1.6 Lloji i procedurës së prokurimit: _____

1.7 Tipi i kontratës: _____

1.8 Fondi limit i përlogaritur për këtë kontratë/marrëveshje kuadër/Fondi limit i përlogaritur për këtë objekt siç është planifikuar në parashikimin buxhetor të Autoritetit/Entit Kontraktor (në rastin e marrëveshjeve kuadër ose kontratave shumëvjeçare) :

1.9 Kohëzgjatja e përafërt e kontratës/marrëveshjes kuadër : _____

1.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe/ose Lotit (eve), nëse përdoren:

1.11. Lloji i Marrëveshjes Kuadër, nëse është rasti:

1.12 Kohën e përafërt për zhvillimin e procedurës së prokurimit:

1.13 Informacion tjetër që konsiderohet i dobishëm nga autoriteti/enti kontraktor: _____

NJOFTIMI I KONTRATËS
(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

Seksioni 1: Autoriteti/Enti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri:	Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara
Adresa:	Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë.
Tel/Faks:	
E-mail:	Suela.Haxhija@mb.gov.al
Adresa e ueb-faqes:	www.abp.gov.al
Personi/at përgjegjës për prokurimin: (emri, e-mail)	Suela.Haxhija@mb.gov.al Suela HAXHIJA

1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

Institucion qendror	Institucioni i pavarur
<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Njësi e autoriteteve vendore	Të tjera
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Autoritet/Ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta	Organ Qendror blerës
<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
I deleguar	Të tjera
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

1.4 Kontratë në bazë të një marrëveshje të posaçme midis Shqipërisë dhe një shteti tjetër:

Po Jo

1.5 Kontrate që bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar:

Po Jo

1.6 Kontratë e rezervuar :

Po Jo

Seksioni 2: Objekti i Kontratës: “Blerje Artikuj ushqimorë”, e ndarë në 7 (shtatë) Lote.

2.1 Numri i referencës së procedurës: REF-45337-10-11-2022

Loti 1 : REF-45346-10-11-2022

Loti 2 : REF-45349-10-11-2022

Loti 3: REF-45352-10-11-2022

Loti 4: REF-45354-10-11-2022

Loti 5: REF-45356-10-11-2022

Loti 6: REF-45358-10-11-2022

Loti 7: REF-45361-10-11-2022

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) 15110000-2, 03142500-3

2.3 Lloji i “Kontratës Publike për furnizim”

Blerje	Marrje me qira	Blerje me këste	Një kombinim i këtyre
X	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:

Po Jo

2.5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër:

Me një Operator Ekonomik
Me disa Operatorë Ekonomikë
Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po Jo

2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me disa Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes

~ Në zbatim të nenit 52/4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në nenin 64 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, përcaktohet se: “Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Meqenëse këto marrëveshje kuadër vlerësohen si kontrata, nuk lejohet të bëhen ndryshime të kushteve të tyre, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e kontratës. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re”

2.7 Marrëveshje Kudër me disa operatorë ekonomikë:

Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: 1 (një) operator ekonomik për secilin lot.

2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:

	<p>Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike .</p>	<p>Nuk do të ketë rihapje të konkursit. Kontrata/ kontratat do të lidhen sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor të përcaktuara në pikën 2.9 të DT, me operatorin ekonomik të suksesshëm. Dhënia e kontratës/ kontratave do të behet nga Autoriteti Kontraktor i përcaktuar në pikën 2.9 të DT. Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatori ekonomik, palë në marrëveshjen kuadër. Ne rast të lindjes së nevojës konkrete për të lidhur një kontratë brenda marrëveshjes kuadër, autoriteti kontraktor duhet që të dërgojë “ftesën për ofertë” tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me sasitë përkatëse të artikujve. Autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik fitues, të japë ofertën e tij. Komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, behet në formë të shkruar ose elektronike (email, fax, etj.) dhe në çdo rast duhet të dokumentohet dhe të behet pjesë e dosjes së procedurës. Sasitë e parashikuara dhe të kerkuara janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t’i blerë ato.</p>
--	---	--

2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore ose Enti/Entet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër: (këtu duhet të listohen të gjitha autoritetet/entet kontraktore që do të jenë palë përfituese nga marrëveshja kuadër)

➤ **Organi Qëndror Blerës, ASHPP, në emer dhe për llogari të autoriteteve kontraktore si më poshtë:**

Për Lotin I. “Blerje bukë gruri dhe simite”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **9,826,665** (nëntë milion e tetëqind e njëzetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, ku janë përfshirë kërkesat e 11 (njëmbëdhjetë) autoriteteve kontraktore si më poshtë:

1. **Qendra e Zvillimit Rezidencial Durrës**, me fond limit në vlerën 579,576 (pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë (pa TVSH).
2. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Bulqizë**, me fond limit në vlerën 432,778 (katërqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë (pa TVSH).
3. **Shtëpia e të Moshuarve Shkodër**, me fond limit në vlerën 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë (pa TVSH).
4. **Qendra Polivalente Kamëz**, me fond limit në vlerën 95,211 (nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e njëmbëdhjetë) lekë (pa TVSH).
5. **Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët**, me fond limit në vlerën 804,967 (tetëqind e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë (pa TVSH).
6. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë**, me fond limit në vlerën 483,333 (katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë (pa TVSH).
7. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Fier**, me fond limit në vlerën 1,293,333 (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë (pa TVSH).
8. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Mat**, me fond limit në vlerën 804,967 (tetëqind e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë (pa TVSH).
9. **Qendra Polivalente Sarandë**, me fond limit në vlerën 478,333 (katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë (pa TVSH).

10. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë**, me fond limit në vlerën 2,700,000 (dy milion e shtatëqind mijë) lekë (pa TVSH).
 11. **Qendra Kombëtare e Viktmave të Dhunës në Familje**, me fond limit në vlerën 649,167 (gjashtëqind e dyzetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë (pa TVSH).
- **Për Lotin II.** “Blerje bulmeti dhe nënprodukte të tij”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **19,865,436 (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë (pa TVSH)**, ku janë përfshirë kërkesat e 3 (tre) autoriteteve kontraktore si më poshtë:
1. **Qendra e Zvillimit Rezidencial Durrës** , me fond limit në vlerën 3,209,701 (tre milion e dyqind e nëntë mijë e shtatëqind e një) lekë (pa TVSH).
 2. **Shtëpia e të Moshuarve Shkodër**, me fond limit në vlerën 6,966,035 (gjashtë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e pesë) lekë (pa TVSH).
 3. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë**, me fond limit në vlerën 9,689,700 (nëntë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë (pa TVSH).
- **Për Lotin III.** “Blerje mishi dhe nënproduktet e tij”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **15,391,643 (pesëmbëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzetë e tre) lekë pa TVSH**, ku janë përfshirë kërkesat e 5 (pesë) autoriteteve kontraktore si më poshtë:
1. **Qendra e Zvillimit Rezidencial Durrës**, me fond limit në vlerën 3,857,528 (tre milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzetë e tetë) lekë (pa TVSH).
 2. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Bulqizë**, me fond limit në vlerën 328,454 (treqind e njëzetë e tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) lekë (pa TVSH).
 3. **Shtëpia e të Moshuarve Shkodër**, me fond limit në vlerën 5,371,404 (pesë milion treqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e katër) lekë (pa TVSH).
 4. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Fier**, me fond limit në vlerën 3,474,702 (tre milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e dy) lekë (pa TVSH).
 5. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë**, me fond limit në vlerën 2,359,555 (dy milion e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë (pa TVSH).
- **Për Lotin IV.** “Blerje Ushqime Koloniale” me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **25,261,731 (njëzetë e pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqinde tridhjetë e një) lekë pa TVSH**, ku është përfshirë kërkesa e 12 (dymbëdhjetë) autoriteteve kontraktore si më poshtë:
1. **Qendra e Zvillimit Rezidencial Durrës** , me fond limit në vlerën 2,905,567 (dy milion e nëntëqind e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë (pa TVSH).
 2. **Shtëpia e të Moshuarve Shkodër**, me fond limit në vlerën 3,631,897 (tre milion e gjashtëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë (pa TVSH).
 3. **Qendra Polivalente Kamëz**, me fond limit në vlerën 444,463 (katërqind e dyzetë e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë (pa TVSH).
 4. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë**, me fond limit në vlerën 1,200,419 (një milion e dyqind mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë) lekë (pa TVSH).
 5. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Fier**, me fond limit në vlerën 1,861,633 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre) lekë (pa TVSH).
 6. **Qendra Polivalente Sarandë**, me fond limit në vlerën 1,168,935 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) lekë (pa TVSH).
 7. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë**, me fond limit në vlerën 3,291,044 (tre milion e dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyzetë e katër) lekë (pa TVSH).
 8. **Qendra e Zhvillimit Pëllumbat, Tiranë**, me fond limit në vlerën 1,239,210 (një milion e dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e dhjetë) lekë (pa TVSH).

9. **Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjaku**, me fond limit në vlerën 6,128,426 (gjashtë milion e njëqind e njëzetë e tetë mijë e katërqind e njëzetë e gjashtë) lekë (pa TVSH).
10. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Gjirokastër**, me fond limit në vlerën 1,747,736 (një milion e shtatëqind e dyzetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë (pa TVSH).
11. **Shtëpia e Foshnjës Tiranë**, me fond limit në vlerën 1,374,136 (një milion e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë (pa TVSH).
12. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Tropojë**, me fond limit në vlerën 268,262 (dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë edyqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë (pa TVSH).
 - **Për Lotin V. “Blerje Vezë”**, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **2,666,129** (dy milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzetë e nëntë) lekë (pa TVSH), ku janë përfshirë kërkesat e 5 (pesë) autoriteteve kontraktore si më poshtë:
 1. **Qendra e Zvillimit Rezidencial Durrës**, me fond limit në vlerën 607,500 (gjashtëqind e shtatë mijë e pesëqind) lekë (pa TVSH).
 2. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Bulqizë**, me fond limit në vlerën 62,604 (gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e katër) lekë (pa TVSH).
 3. **Shtëpia e të Moshuarve Shkodër**, me fond limit në vlerën 525,875 (pesëqind e njëzetë e pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë (pa TVSH).
 4. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë**, me fond limit në vlerën 984,150 (nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë (pa TVSH).
 5. **Shtëpia e të Moshuarve Tiranë**, me fond limit në vlerën 486,000 (katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë) lekë (pa TVSH).
 - **Për Lotin VI. “Blerje Peshq”**, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **308,400** (treqind e tetë mijë e katërqind) lekë (pa TVSH), ku është përfshirë kërkesa e 1 (një) autoriteti kontraktore si më poshtë:
 1. **Shtëpia e të Moshuarve Tiranë**, me fond limit në vlerën 308,400 (treqind e tetë mijë e katërqind) lekë (pa TVSH).
 - **Për Lotin VII. “Blerje Fruta-Perime”**, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **7,873,170** (shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë (pa TVSH), ku janë përfshirë kërkesat e 4 (katër) autoriteteve kontraktore si më poshtë:
 1. **Qendra e Zvillimit Rezidencial Durrës**, me fond limit në vlerën 6,050,960 (gjashtë milion e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë (pa TVSH).
 2. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë**, me fond limit në vlerën 907,020 (nëntëqind e shtatë mijë e njëzetë) lekë (pa TVSH).
 3. **Qendra e Zhvillimit Pëllumbat, Tiranë**, me fond limit në vlerën 646,904 (gjashtëqind e dyzetë e gjashtë mijë e nëntëqind e katër) lekë (pa TVSH).
 4. **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Tropojë**, me fond limit në vlerën 268,286 (dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë (pa TVSH).

2.10 Nërshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **81,193,174 (tetëdhjetë e një milion e njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH ose 696,160** (gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 11.10.2022 është 116.63 lekë).
2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është Nuk aplikohet.**
3. Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:
Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoriteteve kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.

2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:

Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 11.10.2022 është 116.63 lekë).;

2.14.1 Një ofertues mund të aplikojë për:

një Lot,

disa Lote,

X të gjitha Lotet.

Për secilin Lot duhet të paraqitet një ofertë e veçantë.

2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues:

Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t'i jepen një ofertuesi _____

2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:

Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2.

2.14.4 Kombinimi i Loteve në një kontratë/kontrata të përbashkëta (Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një Lot):

Po

Jo

Nëse po, specifikoni grupin e Loteve që mund të kombinohen

2.15 Pranohen variantet:

Po

Jo

X

2.15.1 Pranohet nënkontraktimi:

Po

X

Jo

Nëse lejohet nënkontraktimi, specifikoni përqindjen e lejuar për nënkontraktim:

(nuk lejohet nënkontraktimi në një masë më të madhe se 50 % e vlerës së kontratës)

2.15.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të kryejë pagesa direkte tek nënkontraktori:

Po

Jo

X

Shënime të tjera (nëse vlerësohen të nevojshme nga autoriteti/enti kontraktor)

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po Jo

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

2.17 Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po Jo

2.18. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rast se standardet nuk janë të zbatueshme, merret një miratim paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po Jo

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **1,623,863** (një milion e gjashtëqind e njëzetë e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë (pa TVSH)

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

- **Loti 1.** "Blerje bukë gruri dhe simite", me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është: **196,533** (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.
- **Loti 2.** " Blerje bulmeti dhe nënprodukte të tij", me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është: **397,309** (treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e treqind e nëntë) lekë pa TVSH.
- **Loti 3.** " Blerje mishi dhe nënproduktet e tij " me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është: **307,833** (treqind e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.
- **Loti 4.** " Blerje Ushqime Koloniale " me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është: **505,235** (pesëqind e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
- **Loti 5.** " Blerje Vezë " me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është: **53,323** (pesëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzetë e tre) lekë pa TVSH.
- **Loti 6.** " Blerje Peshq " me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është: **6,168** (gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.
- **Loti 7.** " Blerje Fruta-Perime " me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është: **157,463** (njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

3.1.2 Autoriteti/ enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor:

Kodin e institucionit: 1016132

Kodin e thesarit: 3535

Nr. Llogarisë sipas klasifikimit ekonomik: 4662102 Garanci bankare të vitit vazhdim për sigurimin e ofertës

3.1.3 Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (shprehur në ditë)

Seksioni 4: Procedura

4.1 Lloji i procedurës: E Hapur mbi kufirin e lartë monetar

4.2. Është përdorur njoftimi paraprak / periodik i informacionit:

Po

Jo

X

Nëse Po, numri i referencës është _____

4.2.1. Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave (e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).

Po

Jo

X

4.3 Procedurë e rishpallur:

Po

X

Jo

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) **Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto**

Sipas rëndësisë:

çmimi pikët

_____ pikët

_____ pikët

_____ pikët

Autoriteti/ Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

OSE

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Në rastin e marrëveshjes kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).

Klasifikimi përfundimtar i operatorëve ekonomik të suksesshëm në marrëveshjen kuadër do të bëhet sipas çmimit total të ofertës referuar sasive të pritshme të përcaktuara në shtojcën 6 të DT –së (Sasia dhe grafiku i lëvrimin).

4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: **11.11.2022** (/m/v) ora **11:00**

Vendi: www.app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.

4.6 Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave, sipas parashikimeve në nenin 42 pika 6 të LPP (e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).

Po Jo X

Nëse po, argumentoni arsyet e shkurtimit të këtij afati:

--

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip X Anglisht X

Seksioni 5: Informacione shtesë:

5.1 Dokumente me pagesë (zbatohet vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):

Po Jo X

Nëse po

Monedha _____ Çmimi _____

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së Dokumenteve të Tenderit (DT) tek Operatorët Ekonomik. Operatorët Ekonomik të interesuar kanë të drejtë të konsultojnë DT përpara blerjes së tyre.

5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyra e blerjes së dokumenteve të tenderit (kur është e aplikueshme)

Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi 12.10.2022

[Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër në rihapjen e procesit të mini-konkurrimit]

FITESË PËR OFERTË

(shënoni emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor) fton për paraqitjen e ofertave në procedurën për furnizimin e mallrave në vijim:

.....

(jepni një përshkrim të saktë të mallrave dhe sasisë konkrete të kërkuar:

Vendi i dorëzimit të mallrave: (jepni një përshkrim të shkurtër) _____

Koha e dorëzimit/lëvrimit: Mallrat duhet të dorëzohen brenda datës _____

Ofertat duhet të paraqiten në:

.....[jepni adresën e saktë]

Afati i fundit për pranimin e ofertave:

.....

[Përcaktoni datën dhe orën]

Kriteret për përcaktimin e ofertës fituese _____

Forma e komunikimit:

Forma shkresore

Forma elektronike (e-mail, faks, etj.)

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në

Buletinin e Njoftimeve Publike)

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara

Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nd. 1, 1001, Tiranë

Tel/Faks: +355 42 247 865

E-mail: Suela.Haxhija@mb.gov.al

Ueb-faqe: www.abp.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar", nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me disa operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

3. Numri i referencës së procedurës: REF-45337-10-11-2022

Loti 1 : REF-45346-10-11-2022

Loti 2 : REF-45349-10-11-2022

Loti 3: REF-45352-10-11-2022

Loti 4: REF-45354-10-11-2022

Loti 5: REF-45356-10-11-2022

Loti 6: REF-45358-10-11-2022

Loti 7: REF-45361-10-11-2022

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: "Blerje Artikuj ushqimorë ndarë në 7 (shtatë) lote".

- **Loti I.** "Blerje bukë gruri dhe simite", me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite
- **Loti II.** "Blerje bulmeti dhe nënprodukte të tij", me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite
- **Loti III.** "Blerje mishi dhe nënproduktet e tij", me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite
- **Loti IV.** "Blerje Ushqime Koloniale" me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite
- **Loti V.** "Blerje Vezë", me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite
- **Loti VI.** "Blerje Peshq", me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite
- **Loti VII.** "Blerje Fruta-Perime", me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite

5. Fondi limit: : 81,193,174 (tetëdhjetë e një milion e njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH ose ose 696,160 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mije e njëqind e gjashtëdhjetë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 11.10.2022 është 116.63 lekë) ndarë në 7 lote si më poshtë:

1. **Loti I.** "Blerje bukë gruri dhe simite", me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **9,826,665** (nëntë milion e tetëqind e njëzetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) **lekë (pa TVSH) ose 84,255** (tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 11.10.2022 është 116.63 lekë).;
2. **Loti II.** "Blerje bulmeti dhe nënprodukte të tij", me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **19,865,436** (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) **lekë (pa TVSH) ose 170,329** (njëqind e shtatëdhjetë e mijë e treqind e njëzetë e nëntë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 11.10.2022 është 116.63 lekë).;
3. **Loti III.** "Blerje mishi dhe nënproduktet e tij", me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **15,391,643** (pesëmbëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzetë e tre) **lekë (pa TVSH) ose 131,970** (njëqind e tridhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 11.10.2022 është 116.63 lekë).;

4. **Loti IV.** “Blerje Ushqime Koloniale” me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **25,261,731** (njëzetë e pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqinde tridhjetë e një) **lekë (pa TVSH) ose 216,597** (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 11.10.2022 është 116.63 lekë).;
5. **Loti V.** “Blerje Vezë”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **2,666,129** (dy milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzetë e nëntë) **lekë (pa TVSH) ose 22,860** (njëzetë e dy mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 11.10.2022 është 116.63 lekë).;
6. **Loti VI.** “Blerje Peshq”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **308,400** (treqind e tetë mijë e katërqind) **lekë (pa TVSH) ose 2,644** (dy mijë e gjashtëqind e dyzetë e katër) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 11.10.2022 është 116.63 lekë).
7. **Loti VII.** “Blerje Fruta-Perime”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite, me fond limit të marrëveshjes kuadër: **7,873,170** (shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë) **lekë (pa TVSH) ose 67,506** (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e gjashtë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 11.10.2022 është 116.63 lekë).;

6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:

- **Loti I.** “Blerje bukë gruri dhe simite”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite
- **Loti II.** “Blerje bulmeti dhe nënprodukte të tij”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite
- **Loti III.** “Blerje mishi dhe nënproduktet e tij”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite
- **Loti IV.** “Blerje Ushqime Koloniale” me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite
- **Loti V.** “Blerje Vezë”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite
- **Loti VI.** “Blerje Peshq”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite
- **Loti VII.** “Blerje Fruta-Perime”, me afat të marrëveshjes kuadër 2 (dy) vite

7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: **11.11.2022**; Ora: **11:00**; Vendi: www.app.gov.al, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara në Ministrinë e Brëndshme, Tiranë.

[Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

PLANIFIKIMI I

KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

<input type="checkbox"/> Mallra: Numri i përafërt i kontratave të planifikuara për t'u dhënë në bazë të Marrëveshjes Kuadër _____		
Numri i kontratës	Titulli i kontratës	Përshkrimi i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shënim: Ky planifikim është i përafërt bazuar në nevojat që mund të ketë autoriteti/enti kontraktor dhe orientues për palët në proces.

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Faks _____
E-mail _____
Ueb-faqe _____

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri _____
E-mail _____

3. Lloji i procedurës së prokurimit: _____

4. Lloji i kontratës /Marreveshjes Kuader: _____

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: _____

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _____

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): _____

8. Fondi limit : _____

9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit:

10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar: _____

Shënim:

Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentat e tenderit.

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)
**NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË
ZBATIMIT**

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri _____
Adresa _____
Tel/Faks _____
E-mail _____
Ueb-faqe _____

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri _____
E-mail _____

3. Lloji i procedurës së prokurimit: _____

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuader: _____

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: _____

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër : _____

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): _____

8. Fondi limit: _____

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e mallrave:

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: _____

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): _____

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _____

Dhe afati i ri (nëse është rasti): _____

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:

Emri _____

NIPT: _____

Adresa _____

Kontaktet _____

15. Data e nënshkrimit të modifikimit : _____

16. Burimi i financimit: _____

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor _____

DOKUMENTAT E TENDERIT

Përmbajtja:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë (Udhëzime)

Teksti në Seksionin I nuk mund të modifikohet nga Autoriteti/Enti kontraktor ose operatorët ekonomikë, përveç informacionit të plotësuar sipas Njoftimit të Kontrates.

Seksioni II: Shtojcat

Seksioni II përfshin Shtojcat, të cilët duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik dhe të paraqiten si pjesë e ofertës së tij, si dhe Shtojcat që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor si, specifikimet teknike, kriteret e përzgjedhjes së ofertuesve, sasia dhe grafiku i levrimit.

Seksioni III. Termet dhe Kushtet e Kontratës (TKK)

Seksioni III përmban Kushtet e Përgjithshme dhe të Vecanta që do të zbatohen për të gjitha Kontratat, Formularin e sigurimit të kontratës, si dhe formularë që duhet të nënshkruhen nga të dy palët si, draftet e marrëveshjeve kuadër, sipas llojeve të tyre.

Seksioni IV: Ankimi dhe Njoftimet për mbylljen e procesit

Seksioni IV përfshin formularët standard që përdoren nga operatorët ekonomikë, në procesin e ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe njoftimet që duhet të plotësohen nga autoriteti/enti kontraktor në përfundim të procesit të prokurimit.

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

A. TË PËRGJITHSHME

- | | |
|--|---|
| 1. Objekti i prokurimit | <ol style="list-style-type: none"> 1. Objekti i procedurës së prokurimit, si dhe numri i kontratave (Loteve) dhe objektet e tyre përcaktohen në njoftimin e kontratës. 2. Përveç nëse specifikohet ndryshe më poshtë, përkufizimet dhe interpretimet në këto Dokumente të Tenderit do të jenë sipas përcaktimeve të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPP). |
| 2. Operatorët Ekonomikë të përshtatshëm | <ol style="list-style-type: none"> a) Operator Ekonomik është çdo person fizik ose juridik ose ent publik apo grup personash/entesh, sipas Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë (këtu e më tej referuar si "Udhëzimet"). |

Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë (BOE):

- 1.1. të gjithë operatorët, anëtarë të këtij bashkimi do të kenë përgjegjësi të përbashkët dhe solidare;
- 1.2. BOE i bashkëlidh Ofertës së tij një marrëveshje ndërmjet palëve ku caktohet dhe autorizohet edhe Përfaqësuesi, i cili do të ketë autoritetin të përfaqësojë BOE gjatë procedurës së prokurimit dhe, në rast se BOE shpallet fituese e Kontratës, edhe gjatë zbatimit të Kontratës.

b) Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit do të çojë në refuzimin e Ofertës.

3. Sqarimi i Dokumenteve të Tenderit

Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti/enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti/Enti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

4. Ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit

1. Në çdo kohë para afatit të fundit për paraqitjen e ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i ndryshojë Dokumentet e Tenderit duke hartuar një shtojcë, me këto ndryshime.
2. Çdo shtojcë do të jetë pjesë e Dokumenteve të Tenderit dhe do të publikohet në të njëjtën mënyrë sc është bërë publikimi i Dokumentat ë Tenderit.
3. Nëse ndryshimi i Dokumenteve të Tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit për pranimin e Ofertave, autoriteti apo enti kontraktor mund të zgjasin afatin për pranimin e ofertave. Nëse dokumentet e tenderit ndryshohen në gjysmën e dytë

të afatit për paraqitjen e ofertave, autoriteti/enti kontraktor zgjat afatin e fundit për paraqitjen e ofertave me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

B. PËRGATITJA E OFERTAVE

1. **Shpenzimet e ofertimit** Operatori Ekonomik përballon të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e ofertës së tij, dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk ka detyrime apo përgjegjësi për këto shpenzime, pavarësisht nga zhvillimi apo rezultati i procedurës.
2. **Gjuha e Ofertës** Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.
3. **Dokumentet përbërëse të Ofertës** Oferta do të përmbajë të gjitha dokumentet mbështetëse siç kërkohet nga Autoriteti/Enti kontraktor.
4. **Formularët e tenderit dhe Listat Çmimeve** Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqëruar duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personat e Autorizuar.
5. **Ofertat Alternative** Përveç nëse përshkruhet ndryshe në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit propozimet alternative ose kohët alternative për përfundimin, nuk do të merren parasysh.
6. **Çmimet**
 1. Çmimet e ofruara nga Operatori Ekonomik në Formularin e Ofertës do të jenë në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit.
 2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të dorëzohen, sasi të dhe çmimin e tyre.
 3. Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në valutë të huaj siç përcaktohet në Njoftimin e Kontratës, atëherë ato duhet të konvertohen në Lekë shqiptare (Lekë) sipas kursit të këmbimit të caktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në ditën e dërgimit për publikim të Njoftimit të Kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

4. Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjitha Mallrat pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

Në rastin e një Marrëveshje Kuadër ku NUK përcaktohen të gjitha kushtet, çmimet për kontratat bazuar në Marrëveshjen Kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një mini – konkurrimi midis Operatorëve Ekonomikë, palë në Marrëveshjen Kuadër.

- 7. Monedhat** Monedha (at) e ofertave dhe monedha (at) e pagesës do të jenë siç specifikohet në njoftimin e kontratës.
- 8. Provueshmëria e Kualifikimeve të Operatorit Ekonomik** Për të provuar kualifikimet e tij për realizimin e Kontratës, Operatori Ekonomik do të japë informacionin e kërkuar në Seksionin II: Shtojcat.
- 9. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës**
1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.
 2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërën nga format e mëposhtme:
 - a) Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor
 - b) Garanci bankare
 - c) Garanci sigurimi

Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.
 3. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin/Entin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti/Enti Kontraktor e refuzon Ofertën.
- Nëse autoriteti / enti kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë operatorit ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra sigurimi i ofertës së tij nuk konfiskohet.

- 10. Formati dhe Nënshkrimi i Ofertave** Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, çdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

D. PARAQITJA DHE HAPJA E OFERTAVE

- 11. Paraqitja e Ofertave**
- 11.1 Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, operatorët Ekonomikë duhet të ngarkojnë ofertën e tyre në sistemin e prokurimit elektronik, sipas përcaktimeve në manualët përkatëse.
- 11.2 Lidhur me procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin vetëm ofertën origjinale të mbyllur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: "Ofertë për Furnizimin e Mallrave; Njoftimi Nr. ___.
- “MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE, JO PËRPARA - ----- d/m/v, në orën-----” .**
- 12. Afati i fundit për paraqitjen e Ofertave** Oferta duhet të paraqitet brenda afati të përcaktuar nga autoriteti/enti kontraktor. Nëse autoriteti/enti kontraktor zgjat afatin kohor për pranimin e ofertave, operatorët ekonomikë, mund të paraqesin ofertat e tyre brenda afatit të zgjatur.
- Data e hapjes së ofertave do të jetë e njëjtë me afatin e fundit të paraqitjes së ofertave. Nëse për arsye objektive, të shkaktuara nga një situatë e paparashikuar nga autoriteti/enti kontraktor në kohën e fillimit të procedurës, është e pamundur të respektohet afati për hapjen e ofertave nga autoriteti ose enti kontraktor, arsyeja duhet të dokumentohet dhe të caktohet një datë e re për hapjen e ofertave.
- Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, të cilët kanë paraqitur oferta, ftohen të marrin pjesë në hapjen e ofertave, nëse janë të interesuar. Mosparaqitja e tyre nuk pengon hapjen e ofertave.
- 13. Ofertat me vonesë** Autoriteti/Enti Kontraktor nuk merr në shqyrtim asnjë ofertë që vjen pas afatit të fundit për paraqitjen e tyre siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës. Sistemi i prokurimit elektronik nuk lejon paraqitjen e ofertave që janë në tejkalim të afatit të fundit për paraqitjen e tyre.
- 14. Tërheqja, Zëvendësimi dhe Modifikimet**
1. Operatori Ekonomik mund ta tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë ofertën e tij , në çdo kohë deri përpara afatit të fundit të pranimit të ofertave.
2. Në procedurat e prokurimit të cilat zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose tërheqin ofertat e tyre me kusht që modifikimi ose tërheqja të bëhet para skadimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit/Entit Kontraktor me shkrim, para datës së afatit fundit për paraqitjen e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet: "MODIFIKIM OFERTE" ose "TËRHEQJE OFERTE".

3. Asnjë ofertë nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet pas afatit të fundit për paraqitjen e ofertave.

15. Hapja e Ofertave Ofertat hapen pas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar për pranimin e ofertave në dokumentat e tenderit.

E. SHQYRTIMI I OFERTAVE

16. Konfidencialiteti Autoriteti/enti kontraktor duhet të ruajë konfidencialitetin sipas përcaktimeve të nenit 16 të LPP-së.

17. Sqarimi i ofertave 1. Autoriteti/Enti Kontraktor, gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomikë ofertues. Çdo sqarim i paraqitur nga Operatori Ekonomik që nuk i përgjigjet një kërkesë nga Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të merret në konsideratë. Nuk mund të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në çmimet ose përmbajtjen e ofertave, përveç rasteve të konfirmimit të korigjimit të gabimeve aritmetike të konstatuara nga Autoriteti/Enti Kontraktor gjatë vlerësimit të ofertave.

18. Përgjegjshmëria e ofertave 1. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e Dokumenteve të Tenderit pa devijime materiale, rezerva ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- (a) "**Devijim**" është shmangia nga kërkesat e specifikuara në Dokumentet e Tenderit;
- (b) "**Rezervim**" është përcaktimi i kushteve kufizuese ose mospranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në Dokumentet e Tenderit; dhe
- (c) "**Mospranim**" është mosparaqitja e një pjesë ose e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar në Dokumentet e Tenderit.

2. Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet.

F. VLERËSIMI I OFERTAVE

19. Kualifikimi i Operatorit Ekonomik 1. Për një pjesë të kriterëve të pranimit të kërkuara në dokumentat e tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si një provë paraprake në formën e një deklaratë, ku shprehet se Oferta e tij është në përputhje me Kërkesat Teknike, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit.

